



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr. 353/01-11390

Dt: 01.06.2023

**Komisioni Vlerësues** (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-4819, datës 03.03.2023, duke u bazuar në nenet 4, 5 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 14, 15, 17, 19 dhe të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 011-4819 të datës 03.03.2023 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, me datë 01.06.2023 shpallë këtë:

## NJOFTIM PUBLIK

**Për shprehjen e interesit për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse.**

Ftohen të gjithë të interesuarit të paraqesin ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, sipas njoftimit publik të shpallur nga komuna të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse, në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vitesh.

### **QËLLIMI**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale është:

- Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies;
- Funksionalizimi i pronës komunale.

### **Destinimi i pronës:**

Prona e Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse, do jetë me destinim shfrytëzimi për ushtrimin e aktiviteteve edukative arsimore.

### ***Dokumentet e nevojshme për aplikim:***

- Aplikacioni;
- Kopja e Letërnjoftimit të përfaqësuesit të biznesit/personit fizik;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbaj planin dinamik të investimeve;
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së, për biznesin ekzistues – (origjinali);
- Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarave (për biznesin ekzistues);
- Dëshmia nga aplikuesi që nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata kompetente – (dokumenti origjinal);
- Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për biznesin e ekzistues);
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë;
- Licencat për ushtrimin e aktivitetit edukativ arsimor të lëshuar nga MASHT-ti.

### **Kriteret për zgjedhjen e ofertave:**

Oferta ekonomike më e favorshme që përfshinë:

- Çmimi fillestar 1000 euro në muaj (0 - 40 pikë);
- Vlera e investimit dhe veprimtaria biznesore sipas destinimit të pronës në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vitesh (0- 20 pikë);
- Numri i të punësuarave nga investimi (0 – 15 pikë);
- Lista e të punësuarave aktual dhe kualifikimi i tyre (0 - 15 pikë);
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën (0 - 10 pikë).

Vlerësimi i kriterëve bëhet me poëtim sipas pikëve për secilin kriter të lartcekur. Ofertuesi që mbledh më së shumti pikë shpallet fitues (pikët maksimale janë 100).

### ***Pjesëmarrësit në konkurrim i garantohet e drejta që:***

- Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit;
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

### **Kushtet e përgjithshme të njoftimit publik për shprehjen e interesit:**

- Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatgjatë deri në njëzetë (20) vite.

- Kohëzgjatja e shpalljes së njoftimit publik për shprehjen e interesit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. Ofertat me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimit, kati përdhes, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.
- **Aplikimi fillon nga data 01.06.2023 deri me datë 15.06.2023 në orën 15:30h dhe të protokollohet nga Komuna.**
- **Vendi dhe koha ku do të mbahet njoftimit publik për shprehjen e interesit:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale, me datë **20.06.2023 nga ora 10:00h**. Fillimisht bëhet hapja e ofertave të mbyllura në formë publike, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
- Procedurat e njoftimit publik për shprehjen e interesit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.
- **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditësh pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton pjesëmarrësit për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave.
- Kryesuesi/ja i/e komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai/ajo dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave të njoftimit publik për shprehjen e interesit ankand publik, Komisioni Vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën fituese dhe rekomandon Kryetarin për dërgim/miratim në Kuvend. Nëse kuvendi miraton vendimin përfundimtar, atëherë autorizon Kryetarin e Komunës që brenda dhjetë (10) ditësh pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën më fituesin.

**Vërejtje:** Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.

Kryesuesja e Komisionit



Brilanda Ballata

